



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. 38) Prot.

Tiranë 09 / 08 / 2023

Lënda: Ftesë për pjesëmarrje si anëtar në Komisionin e Pavarur Ad Hoc për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga radhët e avokatisë

Drejtuar: Z. Maksim Haxhia
Avokat

Dhoma e Avokatisë
Rruga "Murat Toptani"
Tiranë

I nderuar z. Haxhia!

Siç jeni në dijëni, me shkresën nr.38, datë 03.08.2023, dërguar përmes postës elektronike, jeni njoftuar për ftesën e bërë nga Avokati i Popullit që në cilësinë e avokatit të dytë më të vjetër në moshë, të shërbeni si anëtar zëvendësues në Komisionin e Pavarur Ad Hoc, për të cilën deri më sot nuk kemi pasur asnjë konfirmim.

Gjithashtu, në përputhje me pikën 2, të nenit 25, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, si dhe mbështetur në listën e dërguar nga Dhoma e Avokatisë në lidhje me avokatët që plotësojnë kriteret e përcaktuara ligjore për anëtar të Komisionit të Pavarur Ad Hoc, Avokati i Popullit i dergoi z. Fatmir Braka ftesën që në cilësinë e avokatit më të vjetër në moshë, të shërbente si anëtar në Komisionin e Pavarur Ad Hoc.

Përmes komunikimit elektronik, z. Braka konfirmon se për arsye personale dhe familjare nuk pranon të jetë anëtar i Komisionit të Pavarur Ad Hoc. Në këto kushte, në përputhje me procedurat e parashikuara nga dispozita e sipërcituar, Avokati i Popullit duhet të kryejë të njëjtën procedurë me kandidatët që pasojnë në listë, sipas kriterit të moshës.

Për rrjedhojë, në cilësinë e avokatit të dytë më të vjetër në moshë, Avokati i Popullit ju fton që të shërbeni tashmë si anëtar në Komisionin e Pavarur Ad Hoc dhe të konfirmoni disponibilitetin tuaj për ushtrimin e kësaj detyre mundësisht brenda një afati sa më të shpejt kohor.

- 4
- Ju rikujtojmë gjithashtu se mbledhjet e Komisionit të Pavarur Ad Hoc parashikohet të zhvillohen fizikisht pas datës 22.08.2023. Ndërkohë, gjatë kësaj periudhe komunikimi për çështje që lidhen me procesin do të jetë në formë elektronike.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin.

Me respekt.

AVOKATI I POPULLIT

Erinda BALLANCA

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Fatbardh Zenelaj

